



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 45

Tiranë – E premte, 25 mars 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 17, datë 15.3.2016	
Me objekt: konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 9376, datë 3.11.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, brenda një afati të arsyeshëm; Konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosgjyqimit brenda një afati të arsyeshëm të çështjes familjare nr. 9658, regjistruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 1.4.2014; Konstatimin e shkeljes të nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.....	3045
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 18, datë 15.3.2016	
Me objekt, shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr. 00-2015-1245 (187), datë 8.4.2015, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	3053
Vendim i Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, datë 3.12.2015	
Çështja Bici kundër Shqipërisë (ankimi nr. 5250/07).....	3059



VENDIM

Nr. 17, datë 15.3.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Bashkim Dedja,	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo,	anëtar i	“	“
Sokol Berberi,	anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha,	anëtar i	“	“
Gani Dizdari,	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha,	anëtare e	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 17.12.2015
mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen
me nr. 57/15 Akti që i përket:

KËRKUES: Urbain Masena

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Dallëndyshe Haruni (Hristopulo), Zyra e
Përmbarrimit Tiranë, Ministria e Drejtësisë

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës
për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e
mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së
prerë nr. 9376, datë 3.11.2008, të Gjykatës së
Rrethit Gjyqësor Tiranë, brenda një afati të
arsyeshëm;

Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces
të rregullt ligjor, si rezultat i mosgjykimit brenda një
afati të arsyeshëm të çështjes familjare nr. 9658,
regjistruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë,
në datën 1.4.2014;

Konstatimi i shkeljes së nenit 8 të Konventës
Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 29, 41, 42, 131/f,
134/1/g dhe 134/2 të Kushtetutës së Republikës
së Shqipërisë; nenet 6, 8 dhe 13 të Konventës
Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577,
datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin
e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipë-
risë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vitore Tusha,
mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të
kërkuesit, që kërkoi pranimin e kërkesës, dhe
prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar,
Ministria e Drejtësisë, që kërkoi rrëzimin e
kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi është babai i një fëmije të lindur në
vitin 2002 nga bashkëjetesa me shtetasen
Dallëndyshe Haruni (subjekti i interesuar). Pas
ndërprerjes së bashkëjetesës dhe largimit nga
shtëpia të Dallëndyshe Harunit bashkë më vajzën,
kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit
Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi me objekt
“Ushtrimi i përgjegjësisë prindërore në lidhje me
fëmijën E.H.”.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me
vendimin nr. 9376, datë 3.11.2008, ka vendosur:
“*Rrëzimin e kërkesëpadisë; ushtrimin e përgjegjësisë
prindërore për fëmijën E.H. nga e ëma e saj; të drejtën e
paditësit të takohet me fëmijën çdo të shtunë ora 10:00 e
mëngjesit deri në orën 10:00 të mëngjesit të ditës së diel, si
dhe ta marrë atë për pushime verore çdo muaj korrik të çdo
viti; detyrimin e paditësit të paguajë për fëmijën e tij një
detyrim ushqimor në masën 10 000 lekë të rinj çdo muaj.
Ky detyrim fillon nga data e ngritjes së padisë, 5.5.2008*”.

3. Kërkuesi për të përmbushur detyrimet që
rridhnin nga vendimi i formës së prerë, tashmë
titull ekzekutiv, i është drejtuar Zyrës Përmba-
rimore Tiranë, e cila ka filluar procedurat me
lajmërimin e subjektit të interesuar, Dallëndyshe
Haruni, për ekzekutimin vullnetar të vendimit
(shkresa nr. 105 prot., datë 15.10.2010). Zyra
Përmbarrimore Tiranë nuk ka mundur të vërë në
ekzekutim vendimin gjyqësor të formës së prerë,
pasi në vitin 2010 Dallëndyshe Haruni është larguar
bashkë më vajzën në Greqi, fakt i cili, sipas
kërkuesit, provohet edhe nga shkresa nr. 7583/3
prot., datë 28.12.2012, e Ministrisë së Brendshme.

4. Nga ana tjetër, subjekti i interesuar i është
drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me
kërkesëpadi me objekt “*Ndryshimin e vendimit të
formës së prerë nr. 9376, datë 3.11.2008 për sa i takon
mënyrës, orareve dhe kohës së takimit të ushtrimit të
përgjegjësisë prindërore...duke i njohur babait të drejtën e
takimit gjatë muajit gusht për pushimet verore nga data 1-
30 gusht dhe në muajin dhjetor nga data 24 dhjetor – 15
janar dhe çdo vit një javë për pashkët ortodokse sipas
periudhës*”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me
vendimin nr. 7623, datë 4.10.2011, ka vendosur
rrëzimin e kërkesëpadisë. Subjekti i interesuar ka
paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila,
me vendimin nr. 731, datë 30.3.2012, ka vendosur
lënien në fuqi të vendimit të mësipërm. Edhe



Gjykata e Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim rekursin e paraqitur nga Dallëndyshe Haruni, me vendimin nr. 00-2015-725, datë 5.3.2015, ka vendosur lënie në fuqi të vendimit të mësipërm.

5. Në vitin 2014 edhe kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me kërkesëpadi me objekt “*Ndryshimin e vendimit të formës së prerë nr. 9376, datë 3.11.2008 dhe ndryshimin e mbiemrit të fëmijës nga Haruni në Masena*”. Sipas kërkuesit, procesi deri në momentin e paraqitjes së kërkesës në Gjykatën Kushtetuese nuk kishte përfunduar ende.

II

6. *Kërkuesi* i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 27.4.2015, me kërkesë për:

6.1 Konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit brenda një afati të arsyeshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 9376, datë 3.11.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Konkretisht ai pretendon se:

6.1.1 Autoritetet shtetërore shqiptare kanë neglizhuar dhe nuk kanë bërë përpjekje për të garantuar respektimin e të drejtave të kërkuesit. Madje ato kanë dështuar në zbatimin e detyrimeve që burojnë nga aktet ndërkombëtare të ratifikuara dhe pjesë të sistemit juridik vendas.

6.1.2 Edhe pse shteti shqiptar ka ratifikuar Konventën e Hagës mbi Aspektet e Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijës, përsëri autoritetet nuk kanë reaguar për të vënë në ekzekutim vendimin gjyqësor të formës së prerë.

6.2 Cenimin e nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, pasi pavarësisht ratifikimit të Konventës së Hagës nga autoritetet shqiptare, në Shqipëri ende mungon një kuadër alternativ ligjor që t'i ofrojë kërkuesit mbrojtjen e duhur praktike dhe efektive që kërkohet nga neni 8 i Konventës dhe qëndrimi i GJEDNJ-së në çështjen “*Bajrami kundër Shqipërisë*”.

6.3 Konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt si rrjedhojë e mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm të çështjes familjare nr. 9658, e regjistruar në datën 1.4.2014 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Edhe pse kërkuesi ka vënë në dispozicion të gjykatës adresën e subjektit të interesuar, seancat përsëri janë shtyrë në mënyrë të vazhdueshme dhe nuk është marrë asnjë masë për njoftimin e palës tjetër, me justifikimin e nevojës së

paraqitjes së fëmijës që psikologu të bëjë vlerësimet përkatëse.

6.4 Mungesa e një mjeti ankimi efektiv kundër vonesës së theksuar në gjykimin e çështjes e legjitimon kërkuesin në paraqitjen e ankimit kushtetues, në referim të neneve 131/f dhe 134/ të Kushtetutës dhe nenit 13 të KEDNJ-së.

7. *Subjekti i interesuar, Zyra Përmbartimore Tiranë*, me shkresën nr. 5691 prot., datë 30.6.2015, paraqiti dosjen përmbartimore për çështjen nr. 17, datë 21.11.2013, ku pasqyrohen të gjitha veprimet e kryera nga ana e tij në funksion të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

8. *Subjekti i interesuar, Ministria e Drejtësisë*, ka prapësuar me shkrim si vijon:

8.1 Njohja e vendimit civil të gjykatës shqiptare nga autoritetet greke kërkohet nga vetë personi i interesuar vetëm pasi të jetë përkthyer dhe legalizuar, sipas parashikimeve ligjore dhe konform marrëveshjes dypalëshe ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë “Për ndihmë gjyqësore në çështjet civile dhe penale”. Kërkuesi është sqaruar e orientuar zyrtarisht lidhur me këto detyrime, si dhe për faktin se kërkesa nuk paraqitet në Ministrinë e Drejtësisë, por pala e interesuar e inicion procesin pranë gjykatës që ka dhënë vendimin, e cila e paraqet më pas atë në Ministrinë e Drejtësisë.

8.2 Sipas marrëveshjes dypalëshe, si dhe bazuar në nenin 219 të Kodit të Procedurës Civile, Ministria e Drejtësisë është autoriteti qendror që realizon komunikimin ndërmjet autoriteteve gjyqësore dhe i kërkon ndihmën juridike organit kompetent të shtetit tjetër. Nisur nga këto detyrime, Ministria e Drejtësisë ka marrë të gjitha masat e nevojshme dhe të duhura për të orientuar kërkuesin në procesin e ekzekutimit të vendimit, duke mbajtur parasysh edhe rrethanat e veçanta të çështjes.

8.3 Kërkuesi nuk legjitimohet për sa i takon kërkimit për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i zgjatjes së gjykimit të dytë të regjistruar në vitin 2014, pasi nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion. Procesi gjyqësor ka përfunduar me vendimin nr. 7699, datë 13.10.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ka vendosur pushimin e gjykimit si rezultat i mosparaqitjes pa shkaqe të arsyeshme të palëve ndërgjyqëse, edhe pse ato kanë pasur dijeni



rregullisht. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 13.10.2015.

8.4 Për më tepër, kërkuesi nuk i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë nëpërmjet ndonjë ankese për zvarritje të procesit gjyqësor. Po ashtu nuk ka ndonjë ankesë të përcjellë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë lidhur me këtë çështje në kuadër të memorandumit të bashkëpunimit “Për shmangien e mbivendosijes së kompetencave të inspektimit gjyqësor”.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Lidhur me legjitimitimin e kërkuarit

9. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se çështja e legjitimitimit të kërkuarit lidhet drejtpërdrejt me inicimin e një procesi kushtetues. Individit, në kuptim të neneve 131, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “g” dhe 134, pika 2, të Kushtetutës, mund të vërë në lëvizje këtë Gjykatë për çështje që lidhen me interesat e tij, kur pretendon se i janë cenuar të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike, çka nënkupton se ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete (*shih vendimet nr. 6, datë 31.3.2006; nr. 27, datë 20.6.2007; nr. 1, datë 19.1.2009, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet të vërë në lëvizje këtë gjykim kushtetues.

10. Po ashtu, bazuar në jurisprudencën e konsoliduar kushtetuese, Gjykata vlerëson se çështja objekt shqyrtimi përfshihet në rrethin e çështjeve të juridiksionit kushtetues, pasi ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 9376, datë 3.11.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, brenda një afati të arsyeshëm, është element i procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të KEDNJ-së.

B. Për pretendimin për mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm

11. Gjykata ka theksuar se ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe për rrjedhojë detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih*

vendimet nr. 1, datë 19.1.2009; nr. 23, datë 17.5.2010; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 9, datë 14.2.2014; nr. 24, datë 22.4.2014, të Gjykatës Kushtetuese).

12. Në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore deri kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces. Në jurisprudencën konstante të Gjykatës, mbështetur edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), është vlerësuar se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes, duke marrë në konsideratë kompleksitetin e saj, sjelljen dhe interesin e kërkuarit, si dhe të autoriteteve përkatëse (*shih vendimet nr. 9, datë 1.4.2009; nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 21, datë 3.6.2011; nr. 9, datë 14.2.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Për rrjedhojë, Gjykata për të vlerësuar nëse në rastin konkret jemi përpara cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, në vijim çmon të analizojë secilin prej elementeve të sipërcituara.

i) Kompleksiteti i çështjes

14. Gjykata ka ritheksuar vazhdimisht se për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve marrin rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e saj, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore (*shih vendimet nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 9, datë 14.2.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në çështje të cilat kanë për objekt të drejtat e fëmijëve, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se në të gjitha veprimet që ndërmerren si nga institucionet publike ose private, nga gjykatat, nga autoritetet administrative ose nga organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë parësor. E drejta e fëmijës së ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit (edhe kur prindërit banojnë në shtete të ndryshme), që të mbajë rregullisht marrëdhënie vetjake dhe takime të drejtpërdrejta me të dy prindërit e tij, me përjashtim të rasteve kur kjo nuk është në interesin më të lartë të fëmijës, duhet respektuar nga shteti (*shih nenet 3, 9/3 dhe 10/2 të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës dhe vendimin nr. 12, datë 15.4.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se vendimi që kërkohet të vihet në ekzekutim ka të



bëjë me të drejtën e kërkuarit, babait të fëmijës, që të takohet me të çdo të shtunë nga ora 10:00 e mëngjesit deri në orën 10:00 të mëngjesit të ditës së diel, si dhe ta marrë atë për pushime verore çdo muaj korrik të çdo viti.

17. Gjykata, duke vlerësuar faktin që vajza bashkë me nënën është larguar dhe jeton në Greqi, si dhe bazuar në natyrën e urdhërimeve të vendimit të formës së prerë, të cilat janë të vazhdueshme/periodike dhe në funksion të sigurimit të interesit të së miturës dhe mirëqenies së saj në të gjitha aspektet, çmon se çështja paraqitet komplekse.

ii) Lidhur me interesin dhe sjelljen e kërkuarit

18. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se vlerësimi i sjelljes dhe i interesit të kërkuarit është një element tjetër përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve (*shih vendimet nr. 1, datë 19.1.2009; nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 24, datë 27.4.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në çështjen në shqyrtim, kërkuari ka depozituar pranë Zyrës së Përmbartimit Tiranë kërkesën për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë në datën 9.7.2010. Po ashtu, kërkuari gjatë periudhës kohore 2010–2015, i është drejtuar në mënyrë të vazhdueshme edhe institucioneve të tjera shtetërore, si Presidentit të Republikës, Kryeministrit, Avokatit të Popullit, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, Prokurorisë së Përgjithshme dhe institucioneve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve (United Nation's Children Fund).

20. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuari nuk është bërë pengesë për mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë, pasi u është drejtuar vazhdimisht organeve shtetërore kompetente, ka bërë përpjekje dhe ka marrë sistematikisht masa për të kërkuar kthimin e së bijës nga Greqia në Shqipëri.

iii) Lidhur me sjelljen e subjektit të interesuar

21. Gjykata duke marrë në konsideratë rrethanat e çështjes, me qëllim garantimin e interesit më të lartë të fëmijës, vlerëson se subjekti i interesuar i ka pasur të gjitha mundësitë për zbatimin e vendimit të formës së prerë.

22. Megjithatë, Gjykata vëren se debitorja nuk ka treguar vullnet për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë që nga momenti i lëshimit të urdhrimit të ekzekutimit të vendimit e në vazhdim,

madje me dashje direkte i është shmangur përbushjes së detyrimeve ligjore. Ky vlerësim i Gjykatës bazohet në fakte si paraqitja nga Dallëndyshe Haruni e kërkesëpadisë me objekt ndryshimin e vendimit të formës së prerë, që u rrëzua në të gjitha shkallët e gjyqimit, si dhe vendimi nr. 2724, datë 15.7.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që e ka deklaruar atë fajtorë për kryerjen e veprës penale “Marrje e padrejtë e fëmijës”, e parashikuar nga neni 127 i Kodit Penal, dhe e ka dënuar atë me 100 000 lekë gjobë.

23. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se sjellja e subjektit të interesuar, nënës së vajzës, ka qenë ndër shkaqet që kanë çuar në mosekzekutimin brenda afatit të arsyeshëm të vendimit të formës së prerë.

iv) Lidhur me sjelljen e autoriteteve përgjegjëse

24. Gjykata ka nënvizuar vazhdimisht se në fazën e ekzekutimit të vendimeve marrin pjesë aktivisht jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Roli i këtyre organeve bëhet vendimtar kur debitori refuzon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin e tij karshi kreditorit. Në raste të tilla procesi i vendosjes në vend i një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe mënyrën e kryerjes së veprimeve konkrete të organeve përgjegjëse, të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (*shih vendimet nr. 6, datë 4.3.2010; nr. 24, datë 22.4.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. GJEDNJ-ja në çështje të këtij lloji ka vlerësuar se përshtatshmëria e një mase gjykohe nga shpejtësia e ekzekutimit të saj, meqenëse kalimi i kohës mund të ketë pasoja të pandreqshme për marrëdhëniet ndërmjet fëmijës dhe prindit që nuk jeton me të (*shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Ignaccolo-Zenide kundër Rumanisë, nr. 31679/96, i datës 25 janar 2000, § 102*).

26. Nisur nga karakteristikat e çështjes në shqyrtim, Gjykata çmon të nevojshme të analizojë nëse përmbartuesi gjyqësor, si subjekti procedural në fushën e ekzekutimit të titujve ekzekutive, ka marrë masat e duhura dhe të përshtatshme për zbatimin e urdhrimit të ekzekutimit, në përputhje me urdhërimet e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

27. Nga rrethanat e çështjes konstatohet se Zyra e Përmbartimit Tiranë, pasi është vënë në lëvizje nga kërkuari në datën 9.7.2010, përmes kërkesës



për ekzekutim të urdhrat të ekzekutimit, në datën 15.10.2010 ka nxjerrë lajmërimin për ekzekutim vullnetar. Po ashtu, nga materialet e vëna në dispozicion konstatohet se në datën 11.10.2013, Zyra e Përmbarrimit, bazuar edhe mbi kërkesën e kreditorit, ka vendosur transferimin e çështjes nr. 105 në Zyrën Përmbarrimore Krujë. Kjo e fundit, në datën 5.11.2013 ka vendosur dërgimin e çështjes përsëri në Zyrën e Përmbarrimit Tiranë, bazuar në kërkesën e kërkuarit, si dhe me argumentin se pala debitoare, Dallëndyshe Haruni, ka vendbanim në Njësinë Bashkiake nr. 9, që është jashtë kompetencës së saj territoriale.

28. Gjykata konstaton se kërkuari ka marrë dijëni zyrtarisht për vendndodhjen në Greqi të vajzës së tij dhe kohën e largimit nga Shqipëria me anë të përgjigjes së institucionit të Avokatit të Popullit të datës 22.1.2013, ku njoftohet se *“shtetaset Dallëndyshe Haruni dhe E.D., pas verifikimit të sistemit TIMS, rezultojnë të kenë dalë nga territori i RSH-së, në datën 3.2.2010 nga pika e kalimit kufitar Kakavijë”*.

29. Lajmërimi i Zyrës Përmbarrimore Tiranë për ekzekutim vullnetar të vendimit të formës së prerë nga ana e debitores mban datën 26.11.2013. Në kushtet e mosgjatjes së vendbanimit / vendqëndrimit të saj, Zyra e Përmbarrimit Tiranë, me shkresat nr. 7136, datë 19.12.2013 dhe nr. 688, datë 23.1.2014, i është drejtuar Drejtorisë së Policisë së Qarkut, komisarivateve të Policisë nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, si dhe Njësisë Bashkiake nr. 9 për vënien në dispozicion të informacionit mbi vendndodhjen e D.H. Në datën 20.5.2014, Zyra Përmbarrimore i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë duke kërkuar mbështetje në ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

30. Në vlerësimin e Gjykatës, edhe pse përmbarruesi gjyqësor nuk ka tagër ligjor për të ndjekur procedurat e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit, institucion ky në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, përmbarruesi duhet të kishte njoftuar Ministrinë e Drejtësisë lidhur me vështirësitë për zbatimin e vendimit në kuadër të detyrimit për informim periodik, parashikuar nga neni 30 i rregullores së organizimit dhe funksionimit të MD-së. Në mungesë të veprimeve të mësipërme, Gjykata vlerëson se sjellja e Zyrës Përmbarrimore Tiranë nuk ka qenë aktive dhe si e tillë nuk ka krijuar mundësi reale për zbatimin e vendimit

gjyqësor të formës së prerë. Në rrethanat e çështjes konkrete, edhe pse masa e përmbarruesit për lajmërim për ekzekutim të detyrueshëm apo vendosja e gjobës ndaj debitores, ose dhe kallëzimi për ndjekje penale potencialisht mund të rezultojnë të pasuksesshme, përsëri Gjykata vlerëson se Zyra Përmbarrimore duhet të merrte të gjitha masat e nevojshme për t'i bërë efektive urdhërimet e vendimit të formës së prerë.

31. Gjykata rithekson qëndrimin se detyrimi për të mbrojtur interesin e fëmijës është një parim thelbësor në sistemin juridik shqiptar dhe, në këtë kuptim, nënvizon se institucionet shtetërore kanë detyrimin t'i trajtojnë me përparësi dhe shpejtësi çështjet, të cilat lidhen me interesat e fëmijëve. Gjykata vlerëson se në rastin konkret detyrimi i institucioneve shtetërore për të zbatuar në mënyrë efektive konventat ndërkombëtare të ratifikuara me ligj buron jo vetëm nga statusi i së drejtës ndërkombëtare në rendin juridik vendas, por edhe nga angazhimet për mbrojtjen e të drejtave në mënyrë konkrete dhe efektive (*shih vendimin nr. 24 datë 21.4.2014, të Gjykatës Kushtetuese*)

32. Nisur nga specifikat e çështjes në fjalë, Gjykata, duke marrë në konsideratë detyrimet që burojnë për autoritetet shqiptare nga ratifikimi i disa instrumenteve ndërkombëtare, si dhe bazuar në parashikimet e legjislacionit të brendshëm, në praktikën gjyqësore, jurisprudencën kushtetuese dhe në atë të GJEDNJ-së, vlerëson të analizojë veçanërisht sjelljen e Ministrisë së Drejtësisë, si autoritet qendror për përmbushjen e angazhimeve të shtetit shqiptar për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.

33. Gjykata vëren se në parashtrimet e paraqitura me shkrim nga Ministria e Drejtësisë, midis të tjerash, analizohet edhe legjislacioni i zbatueshëm në çështjen konkrete, duke renditur Kushtetutën, ligjin nr. 7760, datë 14.10.1994 “Për ratifikimin e “Konventës ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë për ndihmën gjyqësore në çështjet civile dhe penale”, Kodi Civil dhe ligji nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë” i ndryshuar.

34. Gjykata çmon të nevojshme të risjellë në vëmendje faktin se Republika e Shqipërisë ratifikuar një sërë instrumentesh ndërkombëtare për garantimin e të drejtave të fëmijëve, të cilat janë tashmë pjesë e sistemit juridik vendas.



35. Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve (20 nëntor 1989), e cila është e ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 7531, datë 11.12.1991, “Për ratifikimin e “Konventës për të Drejtat e Fëmijës”, u kërkon shteteve palë të marrin masa për të luftuar transferimin e paligjshëm të fëmijëve jashtë shtetit dhe moskthimin e tyre. Për këtë qëllim, shtetet duhet të nxitin lidhjen e marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe ose aderimin në marrëveshjet ekzistuese (*shih nenin 11*).

36. Në përmbushje të detyrimeve të mësipërme, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë, është ratifikuar Konventa “Për ndihmën gjyqësore në çështjet civile dhe penale” (miratuar nga RSH –ja me ligjin nr. 7760, datë 14 tetor 1993). Palët kontraktuese janë angazhuar për të bashkëpunuar për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në territoret e tyre respektive në lidhje me çështjet civile, familjare dhe tregtare (*shih nenet 2, 3, 23 dhe 24 të konventës*).

37. Konventa e mësipërme, midis të tjerash, parashikon se autoritetet gjyqësore të Palëve Kontraktuese do të komunikojnë për qëllime të ndihmës gjyqësore me anë të organeve qendrore të tyre, duke parashikuar si të tilla Ministrinë e Drejtësisë dhe Prokurorinë e Përgjithshme për Shqipërinë. Konventa nuk përjashton edhe mundësinë e përdorimit të rrugës diplomatike si mundësi komunikimi (*neni 3*). Hapësira e ndihmës gjyqësore të ndërsjellë përfshin kryerjen e veprimeve procedurale, veçanërisht transmetimin dhe dorëzimin e dokumenteve, kryerjen e kërkimeve, vënien dorë dhe dorëzimin e provave, kryerjen e ekspertizës, marrjen në pyetje të të akuzuarve, dëshmitarëve, ekspertëve, paditësve e të të paditurve dhe të personave të tjerë, si dhe autopsinë gjyqësore (*neni 4*).

38. Përveç sa më sipër, Shqipëria ka ratifikuar edhe Konventën Evropiane mbi kontaktin në lidhje me fëmijët (“Konventa e Kontaktit”, 15 maj 2003), e cila ka hyrë në fuqi për RSH-në në 1 shtator 2005. Objekti i saj është përcaktimi i parimeve të përgjithshme për zbatimin e vendimeve për kontaktin, për të vendosur masat e duhura mbrojtëse dhe garancitë që sigurojnë ushtrimin e duhur të kontaktit dhe kthimin e menjëhershëm të fëmijëve në fund të periudhës së kontaktit, si dhe vendosja e bashkëpunimit

ndërmjet autoriteteve qendrore, autoriteteve gjyqësore e organeve të tjera, me qëllim që të nxisin dhe përmirësojnë kontaktin ndërmjet fëmijëve dhe prindërve të tyre, si dhe personave të tjerë që kanë lidhje familjare me fëmijët.

39. Gjykata, gjithashtu, konstaton se Kuvendi ka miratuar edhe ligjin nr. 9443, datë 16.11.2005 “Për ratifikimin e “Konventës mbi juridiksionin, e drejta e zbatueshme, njohja, zbatimi dhe bashkëpunimi në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve” (“Konventa e Hagës mbi juridiksionin” e datës 19 tetor 1996). Kjo konventë ka për qëllim përcaktimin e dispozitave të përbashkëta në lidhje me juridiksionin, të drejtën e zbatueshme, njohjen dhe zbatimin e masave për mbrojtjen e fëmijëve dhe parashikon Ministrinë e Drejtësisë si autoritet qendror për përmbushjen e detyrimeve të mësipërme.

40. Po ashtu, pjesë e sistemit juridik shqiptar është edhe Konventa e Hagës “Mbi aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve”, e datës 25 tetor 1980 (*në vijim “Konventa e Hagës”*), e cila është ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me ligjin nr. 9446, datë 24.11.2005 dhe ka hyrë në fuqi në datën 1 tetor 2007. Kjo Konventë ka për qëllim të sigurojë kthimin e shpejtë të fëmijëve që largohen apo mbahen pa të drejtë në shtetin kontraktues dhe që të drejtat e kujdestarisë dhe të kontaktit sipas ligjit të një shteti kontraktues të respektohen efektivisht në shtetet e tjera kontraktuese (*shih nenin 1*).

41. Gjykata konstaton se autoriteti qendror i ngarkuar me plotësimin e detyrave të përcaktuara nga Konventa e Hagës është Ministria e Drejtësisë (*shih nenin 6*), e cila, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo me anë të një ndërmjetësi, për të arritur objektivat e Konventës duhet të marrë masa: a) për të zbuluar vendndodhjen e një fëmije, i cili është larguar apo mbajtur pa të drejtë; b) për të parandaluar dëmtimin e mëtejshëm ndaj fëmijës ose paragjykimin të palët e interesuara duke marrë ose bërë që të merren masa të përkohshme; c) për të siguruar kthimin e vullnetshëm të fëmijës, ose për të arritur një zgjidhje paqësore të çështjeve; d) për të shkëmbyer, aty ku duhet, informacion në lidhje me prejardhjen sociale të fëmijës; e) për të siguruar informacion të karakterit të përgjithshëm sipas ligjit të shtetit të tyre, në lidhje me zbatimin e Konventës; f) për të filluar apo lehtësuar procedimin gjyqësor ose administrativ, me qëllim kthimin e fëmijës dhe në rastin e dubur, për të marrë masat për organizimin ose sigurimin e ushtrimit efektiv të të drejtave të



kontaktit; g) kur e kërkojnë rrethanat, të sigurojë ose lehtësojë sigurimin e konsulencës dhe asistencës ligjore, duke përfshirë pjesëmarrjen e konsulentëve ligjorë; h. të marrë masat e nevojshme administrative, për të siguruar kthimin e sigurt të fëmijës; i. për të informuar në lidhje me funksionimin e kësaj Konvente dhe sa të jetë e mundur, të eliminojë pengesat ndaj zbatimit të saj.” (shih nenin 7 të Konventës).

42. Po ashtu, Gjykata vëren se Konventa, krahas së drejtës së personit për të kërkuar kthimin e fëmijës, i cili është larguar apo mbajtur në shkelje të të drejtave të kujdestarisë, njeh edhe të drejtën e personit për të kërkuar ushtrimin efektiv të të drejtave të tij të kontaktit në të njëjtën mënyrë siç bëhet kërkesa për kthimin e fëmijës, duke iu drejtuar Autoritetit Qendror të vendbanimit të zakonshëm të fëmijës ose të një shteti tjetër kontraktues. Autoritetet qendrore janë të detyruara të bashkëpunojnë, të nxisin gëzimin paqësor të të drejtave të kontaktit dhe plotësimin e kushteve në të cilat mund të jetë objekt ushtrimi i këtyre të drejtave. Ato duhet të ndërmarrin hapa për të shmangur, sa më shumë që të jetë e mundur, pengesat ndaj ushtrimit të këtyre të drejtave dhe qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo me anë të ndërmjetësve, mund të iniciojnë ose ndihmojnë në fillimin e procedimit, me qëllim organizimin ose mbrojtjen e këtyre të drejtave dhe sigurimin e respektimit të kushteve ndaj të cilave mund të jetë objekt ushtrimi i këtyre të drejtave (nenet 8 dhe 21).

43. Përveç sa më sipër, Gjykata vlerëson të sjellë në vëmendje edhe nenin 8 të KEDNJ-së, që parashikon mbrojtjen e individit prej veprimeve arbitrare të autoriteteve publike dhe veçanërisht jurisprudencën e GJEDNJ-së në lidhje me të. Në një sërë çështjesh GJEDNJ-ja është shprehur se ekzistojnë detyrime pozitive të qenësishme për “respektimin” efektiv të jetës familjare (shih *Keegan kundër Irlandës*, vendimi i datës 26 maj 1994, § 49; *Ignaccolo-Zenide kundër Rumanisë*, nr. 31679/96, § 94, 25 janar 2000; *Iglesias Gil dhe A.U.I. kundër Spanjës*, nr. 56673/00, § 49, 29 korrik 2003; *Sylvester kundër Austrisë*, nr. 36812/97, 40104/98, § 51, 24 prill 2003). Lidhur me detyrimin e shtetit për të marrë masa pozitive, GJEDNJ-ja ka arsyetuar vazhdimisht se neni 8 përfshin të drejtën e prindit në marrjen e masave, me qëllim ribashkimin e tij me fëmijën dhe detyrimin e organeve shtetërore për të lehtësuar këtë ribashkim (shih *mutatis mutandis*, *Ignaccolo-Zenide*, § 102; *Maire kundër Portugalisë*, nr.

48206/99, § 74, 26 qershor 2003; *Pini e të tjerë kundër Rumanisë*, nr. 78028/01 dhe nr. 78030/01, § 175, 22 qershor 2004; *Bianchi kundër Zvicrës*, nr. 7548/04, § 85, 22 qershor 2006; *Lombardo kundër Italisë*, nr. 25704/11, 29 janar 2013; *Nicolò Santilli kundër Italisë*, nr. 51930/10, 17 dhjetor 2013).

44. Gjykata, duke iu referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, rithekson se neni 8 i Konventës duhet të zbatohet në përputhje me parimet e së drejtës ndërkombëtare, në veçanti ato që lidhen me mbrojtjen ndërkombëtare të të drejtave të njeriut (shih *Streletz, Kessler dhe Krenz kundër Gjermanisë (DHM)*, nr. 34044/96, 35532/97 dhe 44801/98, § 90, 2001-II dhe *Al-Adsani kundër Britanisë së Madhe [DHM]*, nr. 35763/97, § 55, 2001-XI).

45. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se kërkuesi, duke e vlerësuar Ministrinë e Drejtësisë si autoritet përgjegjës në zbatimin e detyrimeve kushtetuese dhe ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes të të drejtave të fëmijëve, i është drejtuar në mënyrë të përsëritur këtij institucioni. Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, pranë Ministrisë e Drejtësisë, i është përgjigjur kërkuetit me shkresën nr. U-2/4prot., datë 17.2.2015, ku arsyeton se “njohja e vendimit civil të gjykatës shqiptare nga autoritet greke kërkohej direkt nga personi i interesuar vetëm pasi të jenë përkthyer dhe legalizuar konform marrëveshjes dypalëshe ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë “Për ndihmë të ndërsjellët gjyqësore në fushën penale e civile”. Gjykata konstaton se Ministria e Drejtësisë ka mbajtur të njëjtin qëndrim edhe në komentet me shkrim drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 10.12.2015, ku midis të tjerash, shprehet se “...vlerësojmë se Ministria e Drejtësisë ka marrë të gjitha masat e nevojshme dhe të dubura për të orientuar qytetarin në procesin e ekzekutimit të vendimit që po shqyrtohet duke mbajtur në konsideratë edhe rrethanat e veçanta të kësaj çështjeje”.

46. Gjykata çmon se përgjigja e Ministrisë së Drejtësisë ndaj nevojës së kërkuetit për të marrë masa konkrete për të garantuar lidhjen midis tij dhe vajzës nuk është në përputhje me detyrimet pozitive që ka shteti shqiptar në këtë drejtim, në kuptim të së drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Gjykata vlerëson se detyrimet që burojnë për Ministrinë e Drejtësisë nga aktet ndërkombëtare, pjesë e sistemit juridik vendas, nuk kufizohen vetëm në sigurimin e bashkimit të fëmijës dhe prindërit ose kontaktin me ta, por ato



përfshijnë të gjitha masat përgatitore për arritjen e këtij qëllimi. Gjykata thekson se vetëm sqarimi ose orientimi i kërkuesit mbi mjetet juridike në dispozicion është i pamjaftueshëm në kuptim të rolit dhe funksioneve që Konventa e Hagës i ngarkon Ministrisë së Drejtësisë, si autoritet qendror për garantimin e interesit më të lartë të fëmijës.

47. Gjykata vlerëson se angazhimi i Ministrisë së Drejtësisë në çështje që lidhen me mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës duhet të jetë i dukshëm dhe efektiv, dhe me qëllim realizimin e këtij objekti të rëndësishëm, domosdoshmërisht nevojitet marrja e masave emergjente për ngritjen dhe/ose forcimin e kapaciteteve të strukturave institucionale të specializuara për të vepruar brenda një kohe sa më të shkurtër dhe me profesionalizëm për të mundësuar zbatimin me efektivitet të vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Përcaktimi i qartë i mënyrave të bashkëpunimit mes autoriteteve të brendshme, si në rastin konkret gjykatave dhe Ministrisë së Drejtësisë, për t'i bërë praktike dhe efektive garancitë e parashikuara nga marrëveshjet ndërkombëtare, mbetet një çështje prioritare.

48. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se në mungesë të masave të përshkruara më sipër, sjellja e Ministrisë së Drejtësisë në rastin konkret nuk është në përputhje me kërkesën që sistemi juridik shqiptar, pas miratimit të Konventës së Hagës, të ofrojë një kuadër alternativ që i jep kërkuesit mbrojtjen e duhur praktike dhe efektive. Nisur edhe nga ky vlerësim, Gjykata arrin në përfundimin se përpjekjet e Ministrisë së Drejtësisë nuk kanë qenë institucionale dhe as efektive për të mundësuar të drejtat e kontaktit të kërkuesit me vajzën e tij të mitur, të larguar pa lejen e tij në Greqi.

49. Në përfundim, Gjykata konstaton se në çështjen objekt shqyrtimi ndodhemi para cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i KEDNJ-së, si rrjedhojë e mosekzekutimit nga autoritetet e ngarkuara nga ligji dhe brenda një afati të arsyeshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

C. Për pretendimet e tjera

50. Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, konstatimin e cenimit të nenit 8 të KEDNJ-së dhe po ashtu konstatimin e së drejtës për një proces të

rregullt si rrjedhojë e mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm të çështjes familjare nr. 9658, e regjistruar në datën 1.4.2014 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

51. Gjykata vlerëson të mos vijojë me analizën e mëtejshme të pretendimit mbi cenimin e nenit 8 të KEDNJ-së, për sa kohë detyrimet që burojnë nga ky nen i Konventës dhe jurisprudenca e GJEDNJ-së për autoritetet shqiptare, kur çështja ka të bëjë me garantimin e interesit më të lartë të fëmijës, ishin pjesë e vlerësimeve dhe argumenteve për arritjen në përfundimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor për shkak të mosekzekutimit të vendimit të formës së prerë.

52. Për sa i takon pretendimit për mosgjykimin, brenda afatit të arsyeshëm, të çështjes së re familjare të regjistruar në vitin 2014, Gjykata vlerëson se ky pretendim përbën një kërkim të ri të ndryshëm nga kërkimi i parë i objektit të çështjes dhe, si i tillë ai nuk mund të merret në shqyrtim në këtë vendim.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “F” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
 - Konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit brenda një afati të arsyeshëm të vendimit të formës së prerë nr. 9376, datë 3.11.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
 - Rrëzimin e kërkesës për pretendimet e tjera.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtar: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Sokol Berberi, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Fatos Lulo



VENDIM
Nr. 18, datë 15.3.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
 e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Sokol Berberi,	anëtar i	“	“
Vitore Tusha,	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha,	anëtar i	“	“
Gani Dizdari,	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj,	anëtar i	“	“
Fatos Lulo,	anëtar i	“	“
Vladimir Kristo,	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 14.10.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 59/17 Akti, që i përket:

KËRKUESE: HAJRIE NURAJ

SUBJEKT I INTERESUAR: Ambasada e Shtetit të Katarit, përfaqësuar në gjykim me prokurë nga av. Fatos Lazimi.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 00-2015-1245 (187), datë 8.4.2015, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42/2, 59/1/d, 122, 131/f dhe 134/1/g, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6/1 i Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut; nenet 27 dhe 28, të ligjit nr. 8577, datë 10.12.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Vladimir Kristo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkesueses, që është shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Ambasadës së Shtetit të Katarit, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkesja ka qenë e punësuar pranë subjektit të interesuar me anë të kontratës së punës të datës 1.4.2012 në pozicionin e sekretares, detyrë e cila është kryer prej saj deri në datën 24.11.2014 kur

nga ana e punëdhënësit është ndërprerë marrëdhënia e punës.

2. Kërkesja në momentin që ka marrë dëgjimin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke kundërshtuar largimin nga puna dhe duke kërkuar nga gjykata që zgjidhja e kontratës të çmohet si e menjëhershme dhe e pajustificuar, sepse nuk ekziston asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 153/3 të Kodit të Punës (KP).

3. Gjatë shqyrtimit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë, përfaqësuesi i subjektit të interesuar, bazuar në konventën e Vjenës të vitit 1961 “Për marrëdhëniet diplomatike” (në vijim konventa e Vjenës), e cila u siguron përfaqësive diplomatike imunitet ndaj çdo çështje apo padie civile, ka paraqitur kërkesë për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 4709, datë 13.2.2015, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar.

5. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në seancë gjyqësore, me vendimin nr. 00-2015-1245 (187), datë 8.4.2015, mbi ankimin e subjektit të interesuar, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 4709, datë 13.2.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit të gjykatave shqiptare.

II

6. Kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (në vijim “Gjykata”) për shfuqizimin e vendimit objekt kërkesë me pretendimin se:

6.1 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë duke nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar ka cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë të kërkesueses, e cila në këtë mënyrë e ka të pamundur të kërkojë në gjykatë të drejtën e saj të shkelur. E drejta e aksesit edhe pse vihet përballë imunitetit diplomatik nuk mund të reduktohet në mënyrën ose masën që do të shkaktonte cenimin e thelbit të kësaj të drejte.

6.2 Imuniteti që u jepet diplomatëve për të realizuar qëllimin e misionit të tyre diplomatik, sipas përcaktimeve të konventës së Vjenës, nuk mund të kufizojë kurrësi një të drejtë kushtetuese, atë të aksesit në gjykatë, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së.

6.3 GJEDNJ-ja në përballjen e së drejtës së imunitetit diplomatik me atë të aksesit në gjykatë,



në çështjet *Cudak kundër Lituanisë* (vendimi i datës 23.3.2012) dhe *Sabeh El Leil* (vendimi i datës 29.6.2011) ka vendosur në favor të së drejtës për akses të lirë në gjykatë, duke penalizuar shtetet respektive që nuk u kanë lejuar punonjësve të hequr nga puna të paraqisnin një padi në gjykatë me arsyetimin se ndodhemi përpara imunitetit diplomatik.

6.4 Pozicioni i punës së kërkueses, i përcaktuar në kontratën e punës ndërmjet palëve, ka qenë ai i sekretares dhe konsistonte në ndihmesën e stafit diplomatik të ambasadës në çështje të zakonshme. Ky pozicion nuk krijonte mundësinë e aksesit në informacione të rëndësishme të ambasadës.

6.5 Gjykata e Lartë, nisur nga pozicioni i punës së kërkueses, nuk ka arsyetuar përse subjekti i interesuar pengohet në gëzimin e imunitetit të tij diplomatik nëse çështja gjykohet nga gjykatat shqiptare.

6.6 Në raste analoge Gjykata e Lartë ka mbajtur një qëndrim të kundërt lidhur me imunitetin diplomatik (shih vendimin nr. 60/2010 të Gjykatës së Lartë).

7. **Subjekti i interesuar**, Ambasada e Shtetit të Katarit, ka prapësuar në mënyrë të përmbledhur se:

7.1 Kërkuesja nuk ka arritur t'i ngrejë pretendimet e saj në nivel kushtetues. Kërkesa nuk përmban referenca të plota dhe të sakta në jurisprudencën e GJEDNJ-së.

7.2 Vendimi i Gjykatës së Lartë objekt kundërshtimi është i mbështetur në faktet e çështjes dhe në dispozitat e konventës së Vjenës, sipas së cilës ambasada apo përfaqësia diplomatike gëzon imunitet të njëjtë me agentin diplomatik. Qëllimi i këtij përcaktimi është kryerja efikase e funksioneve të misioneve diplomatike si përfaqësues të shteteve.

7.3 Në jurisprudencën e GJEDNJ-së rastet e përmendura nga kërkuesja nuk vënë në dyshim imunitetin e ambasadës apo të përfaqësies diplomatike. Ajo që vihet në diskutim dhe që shqyrtohet rast pas rasti është kufizimi i këtij imuniteti për akte tërësisht të natyrës private.

7.4 Neni 9 i kontratës individuale të punës të lidhur ndërmjet Ambasadës së Shtetit të Katarit dhe kërkueses ka përcaktuar shprehimisht reklamimin e çështjes së imunitetit diplomatik në çdo rast mosmarrëveshjeje mbi interpretimin apo zbatimin e saj.

7.5 Kontrata e punës objekt shqyrtimi hyn në sferën e veprimeve të lidhura direkt me përmbushjen e misionit apo funksionit diplomatik sipas konventës së Vjenës por edhe në kuptim të nenit 11/2/a/d të konventës së Kombeve të Bashkuara për imunitetet juridiksionale të shteteve dhe pronave të tyre (përfashtimet).

7.6 Shkaqet e largimit nga puna të kërkueses në njoftimin për zgjidhjen e kontratës individuale të punës konsistojnë në shkeljen e detyrimeve kontraktore që lidhen me konfidencialitetin dhe disiplinën në punë. Pozicioni i sekretares dhe përkthyeses i mundësonte kërkueses të ishte në kontakt me informacione konfidenciale që lidhen drejtpërsëdrejti me interesat sovrane dhe sensitive të autoritetit të Shtetit të Katarit. Për pasojë, nuk mund të ketë asnjë lloj paralelizmi ndërmjet pozicionit të kërkueses dhe atyre të referuara në çështjet *Cudak kundër Lituanisë* (vendimi i datës 23.3.2012) dhe *Sabeh El Leil* (vendimi i datës 29.6.2011) të GJEDNJ-së.

7.7 Vendimi i Gjykatës së Lartë është dhënë në zbatim të drejtë të ligjit shqiptar në lidhje me çështjen e imunitetit, si dhe të jurisprudencës së Gjykatës së Lartë.

7.8 Kërkueses nuk i mohohet e drejta e aksesit në gjykatë, sepse ajo nuk i ka shteraur të gjitha mjetet kontraktuale dhe ato të njohura nga e drejta ndërkombëtare publike për mbrojtjen e të drejtave të saj.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkueses

8. Gjykata vlerëson se kërkuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të rregullimit kushtetues të neneve 131/f dhe 134/1/g, të Kushtetutës, *ratione temporis*, sepse kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor dyvjeçar të parashikuar nga neni 30/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", si dhe *ratione materiae*, pasi pretendimet e paraqitura në kërkesë *prima facie* përfshihen në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe të së drejtës së aksesit në gjykatë

9. Kërkuesja pretendon se Gjykata e Lartë duke nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar nuk ka arsyetuar se përse subjekti i interesuar pengohet në gëzimin e imunitetit të tij



diplomatik nëse çështja gjykohet nga gjykatat shqiptare. Në këtë mënyrë, sipas kërkujes, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar, i ka cenuar asaj edhe të drejtën e aksesit në gjykatë.

10. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 3, datë 26.1.2015; nr. 63, datë 23.9.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes (*shih vendimet nr. 3, datë 26.1.2015; nr. 63, datë 23.9.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 3, datë 26.1.2015; nr. 63, datë 23.9.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie, përmban referenca në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se detyrimi për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit dhe se masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 3, datë 26.1.2015; nr. 63, datë 23.9.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Ndërsa në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Në vlerësimin e Gjykatës nuk mjafton që arsyetimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 3, datë 26.1.2015; nr. 63, datë 23.9.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin në shqyrtim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar, duke arsyetuar se objekti i shqyrtimit është një mosmarrëveshje që rrjedh nga marrëdhëniet e punës, në të cilën punëdhënësi sipas konventës së Vjenës (1961) "Mbi marrëdhëniet diplomatike" gëzon imunitet diplomatik, pasi konflikti gjyqësor nuk përbën asnjë prej rasteve përjashtimore të përcaktuara në nenin 31 të saj. Gjithashtu, Gjykata e Lartë argumenton se subjekti i interesuar, Ambasada e Shtetit të Katarit, nuk ka hequr dorë në mënyrë të shprehur nga ky imunitet, çka do të justifikonte nënshkrimin e saj juridiksionit të gjykatave shqiptare. Në të



njëjtën kohë në kontratën e punës së lidhur midis palëve nuk rezulton që ato të kenë përcaktuar gjykatën kompetente për zgjidhjen e konflikteve që lindin nga zbatimi dhe interpretimi i saj (*shih faqet nr. 8–9 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

16. Nisur nga rrethanat e çështjes në fjalë, Gjykata çmon me vend t'i referohet jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), e cila lidhur me parimin e imunitetit diplomatik është shprehur në disa çështje. Standardet e përgjithshme të zbatimit të këtij parimi janë evidentuar fillimisht në dy vendime të Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së, *Cudak kundër Lituanisë*, vendimi i datës 23.3.2010 dhe *Sabeh El Leil kundër Francës*, vendimi i datës 29.6.2011, qëndrime të cilat janë rikonfirmuar prej saj edhe në vendimmarrjen në vijimësi (*Wallishanser kundër Austrisë*, vendim i datës 17.7.2012 dhe *Oleynikov kundër Rusisë*, vendim i datës 14.3.2013).

17. Në çështjen *Cudak kundër Lituanisë*, të lartpërmendur, GJEDNJ-ja ka theksuar se e drejta e aksesit, e mishëruar nga neni 6/1 i KEDNJ-së, duhet të interpretohet nën dritën e rregullave të përcaktuara në konventën e Vjenës të 23 majit 1969 “Mbi marrëdhëniet diplomatike”. Gjykatat duhet të jenë të ndërgjegjshme për karakterin e veçantë të konventës të Vjenës, si një traktat i të drejtave të njeriut, dhe ato duhet gjithashtu të marrin në konsideratë rregullat përkatëse të së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë edhe ato që lidhen me dhënien e imunitet shtetit (*shih Cudak të cituar më lart, paragrafi nr. 56*). Për pasojë, në parim nuk mund të konsiderohet se masat e marra nga një palë e lartë kontraktuese, të cilat pasqyrojnë rregullat përgjithësisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare publike për imunitetin diplomatik, të imponojnë një kufizim disproporcional mbi të drejtën e aksesit në gjykatë (*shih Cudak të cituar më lart, paragrafi nr. 57*).

18. GJEDNJ-ja arriti në përfundimin se në rastet kur zbatimi i parimit të imunitetit shtetëror kufizon ushtrimin e së drejtës së aksesit në gjykatë, gjykata duhet të konstatojë nëse rrethanat e rastit e justifikojnë një kufizim të tillë (*shih Cudak të cituar më lart, paragrafi nr. 59*).

19. Në vendimin e saj të mëvonshëm *Sabeh El Leil kundër Francës*, të lartpërmendur, GJEDNJ-ja ka shtuar se parimi i imunitetit të Shtetit në ligjin ndërkombëtar u bazua në parimin *par in parem diktatin non habet imperium*, sipas të cilit një shtet nuk

mund të jetë subjekt i juridiksionit të një shteti tjetër. GJEDNJ-ja ka konsideruar se dhënia e imunitet një shteti në procedurat civile ndjek qëllimin legjitim të veprimit në përputhje me të drejtën ndërkombëtare për të promovuar marrëdhëniet e mira mes shteteve përmes respektimit të sovranitetit të një shteti tjetër (*shih Sabeh El Leil të cituar më lart, paragrafi nr. 52*).

20. Lidhur me zbatimin e parimit të imunitetit absolut të shtetit, GJEDNJ-ja ka vërejtur se nëpër vite ai është zbehur në mënyrë të qartë, në veçanti me miratimin e konventës për imunitetet juridiksionale të shteteve dhe të pronave të tyre nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 2004. Kjo konventë u bazua në projektnevet e vitit 1991, neni 11 i të cilave kishte të bënte me kontratat e punës, dhe krijoi një përjashtim të rëndësishëm në çështjet e imunitetit shtetëror, parim i cili nënkupton se rregulli i imunitetit diplomatik nuk zbatohet në kontratat e punësimit të shtetit me stafin e përfaqësive të tij diplomatike jashtë vendit, me përjashtim të situatave të përcaktuara në mënyrë shteruese në paragrafin 2 të nenit 11 (*shih Sabeh El Leil të cituar më lart, paragrafi nr. 53*).

21. Për më tepër, sipas GJEDNJ-së në të drejtën ndërkombëtare është një parim i gjithëpranuar se dispozita e një traktati, përveç detyrimeve që krijon për palët kontraktuese, mund të jetë e detyrueshme për shtetet që nuk e kanë ratifikuar atë për aq sa kjo dispozitë reflekton të drejtën ndërkombëtare zakonore ose “kodifikimin” apo formimin e një rregulli të ri zakonor. Rrjedhimisht, neni 11 i projektneveve të Komisionit të së Drejtës Ndërkombëtare, siç parashikohet tashmë në konventën e vitit 2004, zbatohet sipas së drejtës zakonore ndërkombëtare edhe në qoftë se shteti në fjalë nuk e ka ratifikuar këtë konventë, me kusht që ai të mos e ketë kundërshtuar atë (*shih Sabeh El Leil të cituar më lart, paragrafi nr. 54*).

22. Në të gjitha çështjet e lartpërmendura nga jurisprudenca e GJEDNJ-së theks i veçantë i vihet natyrës së mosmarrëveshjes dhe natyrës së pozicionit të punës së aplikantit. Në këtë kontekst, GJEDNJ-ja ka arritur në përfundimin se edhe pse imunitetet sovrane mund ta justifikojnë deri diku kufizimin e së drejtës së aksesit në gjykatë, pengesa e të punësuarve nëpër ambasada për të paditur punëdhënësit e tyre përbën një kufizim



joproporcional të së drejtës së aksesit në gjykatë, sidomos në rastet kur këta punonjës nuk kanë qenë pjesë e stafit konsullor ose diplomatik apo shtetas të shtetit të huaj dhe kur nuk kanë kryer funksione që lidhen me sovranitetin e shtetit të huaj.

23. Nën dritën e parimeve të trajtuara nga jurisprudenca e GJEDNJ-së, Gjykata vlerëson se qëllimi i konventës së Vjenës nuk është t'i japë misionëve diplomatike imunitet të pakufizuar për çdo lloj përgjegjësie civile, por vetëm për ato veprime që çmohen se janë përmbushje e objektit të veprimtarisë së tyre. Në këtë kuptim, jo çdo veprim juridiko-civil i kryer nga ana e subjekteve që pretendojnë gëzimin e imunitetit diplomatik, për më tepër kur kemi të bëjmë me lidhje të kontratave të punësimit me shtetas të vendit ku ndodhet përfaqësia diplomatike (shqiptar në rastin në fjalë), përbën vetvetiu veprim “*të lidhur direkt*” me kryerjen e veprimtarisë së saj.

24. Gjithashtu, Gjykata thekson se në zgjidhjen e çështjeve të juridiksionit, në këto raste, gjykatat duhet t'u përmbahen edhe normave dhe parimeve të njohura të së drejtës ndërkombëtare, lidhur me qëllimin dhe zbatimin e “*imunitetit të kufizuar*” nga juridiksioni. Në këtë vlerësim duhet mbajtur parasysh se nëse objekt i gjykimit është një akt (veprim) publik (*acta iure imperii*), apo një akt privat (*iure acta gestionis*), që nuk cenon sovranitetin e shtetit tjetër (*sikurse mund të jenë ato të punësimit*). Gjykata konstaton se këto parime kanë gjetur zbatim edhe në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë në raste analoge (*shih vendimin nr. 60, datë 9.2.2010, i Gjykatës së Lartë*).

25. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk përmbush standardet e përmendura më lart, si dhe nuk ka marrë parasysh evolucionin e jurisprudencës së GJEDNJ-së lidhur me zbatimin e parimit të imunitetit diplomatik. Në këtë këndvështrim, Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë nuk ka hetuar mbi detyrat konkrete të kryera nga kërkuesja dhe nuk ka arsyetuar nëse ekzistonin apo jo kushtet për zbatimin e nenit 11 të konventës së Kombeve të Bashkuara, e cila luan rolin e normave të së drejtës ndërkombëtare zakonore. Ndërsa referenca te vendimi nr. 8, datë 10.6.2011, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, është i gabuar, pasi në atë vendim rasti që shqyrtohej parashikohej nga një marrëveshje dypalëshe midis Qeverisë Shqiptare dhe SHBA-së.

26. Gjykata gjithashtu konstaton se pretendimet e subjektit të interesuar se kërkuesja ka pasur qasje në dokumente të caktuara që ajo përkthente dhe i përcillte përfaqësuesve më të lartë të Ambasadës së Shtetit të Katarit, pra me materiale konfidenciale të cilat lidheshin drejtpërsëdrejti me interesat sovrane dhe sensitive të autoritetit të Shtetit të Katarit, nuk kanë gjetur përgjigje në vendimin e Gjykatës së Lartë, për më tepër kur kontrata e punës e administruar në gjykim nuk jep detaje mbi detyrat e kryera nga kërkuesja, ndërsa neni 5 i saj përcakton detyra të përgjithshme, nga të cilat nuk mund të kuptohet nëse ato (detyrat e kërkueses) objektivisht kanë qenë të lidhura me çështje të konfidencialitetit që cenojnë imunitetin diplomatik të subjektit të interesuar. Në të njëjtën kohë, Gjykata vëren, sikurse rezulton edhe në vendimin e Gjykatës së Lartë, se në kontratën e punës së lidhur midis palëve ato nuk kanë përcaktuar gjykatën kompetente për zgjidhjen e konflikteve që lindin nga zbatimi dhe interpretimi i saj (*shih nenin 9 të kontratës së punës*).

27. Duke ju referuar edhe një herë jurisprudencës së GJEDNJ-së, kjo e fundit në zbatimin e parimeve të përgjithshme të lart-përmendura (shih paragrafët 17-21) në rastet konkrete, në çështjen *Sabeh El Leil*, ka vërejtur se edhe pse gjykatat franceze (gjykata e apelit dhe ajo e Kasacionit) kishin përmendur se kërkuesi kishte “përgjegjësi shtesë”, të cilat nënkuptonin se ai nuk ka kryer veprime të thjeshta të administratës, por kishte një shkallë të autonomisë që nënkuptonte se ai kishte kryer aktivitetet në interes të shërbimit diplomatik publik dhe në këtë mënyrë ka marrë pjesë në aktet e autoritetit qeveritar të Shtetit të Kuvajtit, ato nuk kishin arsyetuar mbi këtë fakt. Gjykatat franceze, sipas GJEDNJ-së, nuk kishin sqaruar mbi çfarë prove - dokumente ose fakte – kishin arritur në këtë përfundim (*shih Sabeh El Leil të cituar me lart, paragrafët nr. 63-65*). Për më tepër, GJEDNJ-ja vërejt se gjykata e apelit dhe Gjykata e Kasacionit nuk arritën të marrin në konsideratë dispozitat e nenit 11 të konventës së vitit 2004, në mënyrë të veçantë përjashtimet e renditura në këtë nen, të cilat duhet të interpretohen në mënyrë rigorozë (*shih Sabeh El Leil të cituar me lart, paragrafi nr. 66*).

28. Bazuar në këtë jurisprudencë të GJEDNJ-së, Gjykata thekson se Gjykata e Lartë në rastin në shqyrtim nuk mund të bazohet në hamendësime



për të vlerësuar nëse kërkesja me veprimet e saj ka cenuar parimin e imunitetit diplomatik. Ajo duhet të hetojë dhe t'u japë përgjigje të arsyetuara si pretendimeve të kërkuases, ashtu edhe prapësimeve të subjektit të interesuar lidhur me natyrën e pozicionit të kërkuases dhe detyrat e kryera konkretisht prej saj. Me fjalë të tjera, Gjykata e Lartë duhet të arsyetonte nëse kërkesja ka kryer funksione të veçanta të lidhura ngushtë me ushtrimin e autoritetit qeveritar të Shtetit të Katarit.

29. Nga ana tjetër, Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit) (*shih vendimin nr. 3, datë 26.1.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se është detyrë e Gjykatës së Lartë që në zbatim të parimeve të jurisprudencës së GJEDNJ-së të hetojë dhe të japë përgjigje në vendim nëse kontrata e punës objekt shqyrtimi hyn në sferën e veprimeve “*të lidhura direkt*” me përmbushjen e misionit apo funksionit diplomatik sipas konventës së Vjenës ose në kuptim të nenit 11 të konventës së Kombeve të Bashkuara të 2004, si dhe nëse kërkesja ka pasur “përgjegjësi shtesë” të bazuara në prova, të cilat mund të cenonin parimin e imunitetit diplomatik të subjektit të interesuar. Gjithashtu, Gjykata thekson se Gjykata e Lartë duhet të sqarojë paqartësitë që rezultojnë nga formulimi i nenit 9 të kontratës së punës së lidhur ndërmjet palëve, sipas të cilit në rast mosmarrëveshjeje mbi interpretimin ose zbatimin e saj, nëse palët nuk e zgjidhin atë miqësisht, “*objekti i mosmarrëveshjes do t'i kalohet autoritetit gjyqësor kompetent*”, pa përcaktuar se për kë autoritet gjyqësor bëhet fjalë.

31. Në të njëjtin këndvështrim, Gjykata vlerëson se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, duke mos e arsyetuar vendimin për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor shqiptar i ka mohuar kërkuases edhe të drejtën e aksesit në

gjykatë, si dhe të drejtën për të pasur një vendim përfundimtar që do t'i jepte përgjigje pretendimeve të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë, për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Në këtë kuptim, ky standard përfshin të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën për çështjet civile, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit në një organ gjyqësor duhet të jetë një e drejtë që lidhet me themelin dhe jo një e drejtë e pastër formale. Aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 2, datë 29.1.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, Gjykata vlerëson se në rastin konkret Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka cenuar standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor dhe të drejtën e aksesit në gjykatë, si elemente të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, pretendimet e kërkuases në këtë drejtim janë të bazuara dhe duhen pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “P”, dhe 134, pika 1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtuashëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2015-1245 (187), datë 8.4.2015, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.



Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtar: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Sokol Berberi, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vladimir Kristo, Fatos Lulo

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I PARË
ÇËSHTJA BICI KUNDËR SHQIPËRISË
(Ankimi nr. 5250/07)

VENDIM
STRASBURG
3 dhjetor 2015

Ky vendim do të bëhet i formës së prerë sipas rrethanave të parashikuara në nenin 44§2 të Konventës. Ai mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktues.

Në çështjen Bici kundër Shqipërisë,
Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
(Seksioni i Parë), e mbledhur si Dhomë e përbërë nga:

Mirjana Lazarova Trajkovska, *presidente*
Päivi Hirvelä,
Ledi Bianku,
Paul Mahoney,
Aleš Pejchal,
Robert Spano,
dhe Armen Harutyunyan, *gjyqtarë*,
dhe André Wampach, *zëvendëssekretar i Seksionit*,
pasi ka diskutuar me dyer të mbyllura, më 10 nëntor 2015,

lëshon vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë ditë:

PROCEDURA

1. Çështja filloi me një aplikim (nr. 5250/07) kundër Republikës së Shqipërisë, paraqitur në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) nga një shtetas shqiptar, z. Xhaferr Bici (ankuesi), më 4 dhjetor 2006.

2. Ankuesi përfaqësohej nga znj. S. Puto, një avokate që ushtron detyrën në Tiranë. Qeveria shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga agentja e asaj në atë kohë, znj. E. Hajro nga Zyra e Avokatit të Shtetit.

3. Ankimi iu komunikua Qeverisë, më 5 shkurt 2009.

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

A. Procedurat për kthimin e pronës

4. Ankuesi ka lindur në vitin 1926 dhe jeton në Durrës.

5. Babai i ankuesit ishte pronari i dy sipërfaqeve toke bujqësore, të cilat në një moment të caktuar u shpronësuan nga regjimi komunist.

6. Më 19 shtator 1996, Gjykata e Rrethit Durrës njohu ekzistencën e të drejtave të ankuesit mbi pronën e trashëguar, e cila është një sipërfaqe toke bujqësore prej 72,000 m², në përputhje me nenin 388 të Kodit Civil (*vërtetim fakti juridik*). Parashikimi operativ parashikon si më poshtë vijon:

“Gjykata pranon kërkesë padinë të paditësit Xhaferr Bici dhe njeh ekzistencën e faktit juridik se babai i tij zotëronte një sipërfaqe toke bujqësore 72,000 m² (...). Kjo njohje bëhet për efekt kompensimi”.

7. Më 26 shtator 1996, ankuesi, në mbështetje të vendimit të Gjykatës së Rrethit, dorëzoi një ankesë te Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (Komisioni), duke kërkuar njohjen, kthimin dhe/ose kompensimin e pronës.

8. Nga viti 2001 deri në vitin 2008, ankuesi i kërkoi një sërë autoriteteve t’i njihnin të drejtën e tij mbi pronën dhe t’ia rikthenin pronën.

9. Më 11 mars dhe 19 nëntor 2002, Prefektura e Qarkut Durrës dhe Komisioni deklaruan se ankimi kishte mbetur pezull që prej vitit 1996. Gjithashtu, Komisioni deklaroi se ankimi duhej të shqyrtohej në bazë të ligjit për pronën, i vitit 1993, i amenduar.

10. Më 28 gusht 2007, Komisioni konfirmoi se nuk ishte marrë asnjë vendim në lidhje me ankimin e datës 26 shtator 1996. Letra përfshinte një listë me dokumente, të cilat ishin pjesë e dosjes së ankuesit.

B. Ngjarjet që dolën pas komunikimit të çështjes

11. Më 14 korrik 2008, Komisioni i ktheu ankuesit ankimin e tij të datës 26 shtator 1996. Në të deklarohet se nuk mund të merrej asnjë vendim në lidhje me fuqizimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit, të datës 19 shtator 1996, bazuar në seksionin 17 të vitit 2004, të ligjit mbi pronën, i amenduar (shiko paragrafin 16 më poshtë). Më tej, vërehet se ligji mbi pronën, i vitit 1993, dhe aktet ligjore statutoare në vijim, të cilat parashikonin



njohjen e të drejtave të pronës bazuar në një vendim i cili njihje ekzistencën e faktit juridik për të drejtat e pretenduara mbi pronën, ishte zëvendësuar.

12. Nuk ka asnjë konfirmim se letra e Komisionit, e datës 14 korrik 2008, është marrë nga ankuesi.

II. LIGJI DHE PRAKTIKA PËRKATËSE VENDASE

A. Ligjet për pronën (*ligji për kthimin dhe kompensimin e pronës*)

13. Ligjet për pronën përshkruhen me detaje në vendimet e *Gjonbocari kundër Shqipërisë* (nr. 10508/02, 23 tetor 2007); *Drizja kundër Shqipërisë* (nr. 33771/02, 13 nëntor 2007); *Ramadhi kundër Shqipërisë* (nr. 38222/02, 13 nëntor 2007); *Hamzaraj kundër Shqipërisë (nr. 2)* (nr. 45265/04, 22 shtator 2009); *Luli dhe të tjerët kundër Shqipërisë* (nr. 64480/09, 64482/09, 12874/10, 56935/10, 3129/12 dhe 31355/09, 1 prill 2014); dhe *Manushaqe Puto dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, nr. 604/07, 43628/07, 46684/07 dhe 34770/09, 31 korrik 2012.

14. Parashikimet përkatëse, në lidhje me këtë çështje, janë si më poshtë vijon:

15. Seksioni 22, i ligjit për pronën, i vitit 1993, parashikon se njohja e së drejtës së pronës bazohej në dokumentet zyrtare që duhej të dorëzoheshin nga pronari i mëparshëm. Në mungesë të këtyre dokumenteve zyrtare, ekzistenca e të drejtave të pretenduara mbi pronën mund të njihet me anë të një vendimi gjykate në prani të palës së pandehur. Për rrjedhojë, një pronar i mëparshëm ka të drejtën të paraqesë një ankim përpara Komisionit për njohjen e të drejtave të tij të pretenduara për pronën e trashëguar, bazuar në një vendim të tillë gjykate. Ligji për pronën, i vitit 2004, shfuqizon ligjin për pronën të vitit 1993.

16. Sipas seksionit 17 të ligjit për pronën, të vitit 2004, i amenduar, afati kohor për dorëzimin e ankesave të reja u shty. Gjithashtu, u parashikua se Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në Tiranë (Agjencia Qendrore), nuk do të merrte ndonjë vendim në lidhje me ankesat, pretendimet e të cilave bazoheshin vetëm në një vendim gjykate, i cili njihje ekzistencën e një fakti ligjor në përputhje me nenin 388 të Kodit të Procedurës Civile. Të gjitha ankesat e bazuara në një vendim të tillë do t'i ktheheshin paditësit brenda tridhjetë ditëve nga

dorëzimi dhe nuk do të ndërmerrej asnjë veprim i mëtejshëm.

17. Seksioni 19 § 1 i ligjit për pronat, i vitit 2004, prashikonte mundësinë për dorëzimin e ankesave të reja për njohjen, kthimin dhe kompensimin e një prone. Në përputhje me seksionin 22, një pronar i mëparshëm mund të bënte një ankesë të re për njohjen, kthimin ose kompensimin e pjesës së mbetur të pronës, çka ishte vendosur më herët nga Komisioni.

B. Ligje të tjera vendase të lidhura me çështjen në fjalë

18. Sipas nenit 324 të Kodit të Procedurës Civile (KPP), një paditës mund të kërkojë anulimin e një vendimi administrativ. Gjithashtu, një paditës mund të kundërshtojë refuzimin e autoriteteve për ndërmarrjen e një vendimi administrativ brenda afatit kohor të përcaktuar.

19. Neni 388 i KPP-së, parashikon se çdo palë e interesuar ka të drejtën të kërkojë që gjykata e shkallës së parë të njohë një fakt, të dhënat e dokumentuara të të cilit janë zhdukur, kanë humbur dhe nuk mund të krijohen përsëri, ose nuk mund të përftohen në mënyrë tjetër, vetëm nëse një fakt i tillë është material dhe mund të shkaktojë, ndryshojë ose ndalojë të drejtat personale ose ato mbi pronën.

20. Neni 77 i Kodit të Procedurës Administrative (KPA) parashikon refuzimin e nënkuptuar nga një autoritet shtetëror në rast se nuk është marrë asnjë vendim brenda nëntëdhjetë ditësh në lidhje me ankimin. Sipas nenit 137 të KPA-së, një palë e interesuar mund të apelojë, *inter alia*, kundër refuzimit për çuarjen e një vendimi administrativ në gjykatë, pasi janë shteruar mjetet respektive administrative.

21. Sipas ligjit për detyrimet ekstra kontraktuale të shtetit (ligji nr. 8510, i datës 15 korrik 1999), një shtet është i detyruar të kompensojë dëmin shkaktuar ndaj një pale të tretë gjatë ushtrimit të funksioneve të tij publike, në rast se ky dëm dhe kompensim nuk është njohur nga ai entitet.

C. Praktika vendase

22. Në vitet 2007 dhe 2008, Gjykata e Lartë sqaroi përfundimisht praktikën e gjykatësve vendase në lidhje me zbatimin e nenit 388 të Kodit të Procedurës Civile. Më specifikash, në vendimet e saj nr. 746/2007, të datës 31 maj 2007 dhe 98/2008, të datës 14 shkurt 2008, në lidhje me mosmarrëveshjet për pronën, Gjykata e Lartë shtoi



se “një vendim gjykate i marrë në përputhje me nenin 388 të Kodit të Procedurës Civile, nuk duhet të interpretohet si i lidhur me autoritetet administrative, por si një dokument udhëheqës që i mundëson atyre të marrin një vendim bazuar në ligj dhe në dokumentet që zotërohen”. Në vendimin nr. 749/2007, të datës 31 maj 2007, Gjykata e Lartë shtoi se “një vendim i tillë gjykate duhet të shqyrtohet në kombinim me dokumente shtesë mbështetës nga Agjencia, e cila duhet të vendosë përfundimisht nëse duhet të pranojë ose të rrëzojë kërkesën e ankuesit [për njohjen e të drejtave të tij mbi pronën]”.

LIGJI

I. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

23. Nga mocioni i saj, Gjykata ngriti çështjen nëse kishte pasur një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me mosmarrjen e një vendimi nga ana e autoriteteve për pakënaqësinë e paraqitur nga ankuesi në vitin 1996.

24. Në vëzhgimet e tij, ankuesi shfaqti pakënaqësinë se kohëzgjatja e procedimeve përpara Komisionit nuk pajtohej me kërkesën për “kohë të arsyeshme”, parashtruar në nenin 6 § 1 të Konventës, i cili, për sa ka të bëjë me çështjen, parashikon:

“Në përcaktimin e të drejtave dhe të detyrimeve të tij civile..., çdo njeri ka të drejtën ... për një seancë dëgjimore brenda një afati kohor të arsyeshëm nga ... një gjykatë...”

A. PRANUESHMËRIA

1. Zbatimi i nenit 6 § 1

25. Qeveria e kontestoi pranueshmërinë e nenit 6 § 1 të Konventës për zbatimin e një vendimi gjykate, i cili njeh ekzistencën e një fakti juridik. Qeveria argumenton se në çështjen në fjalë nuk kishte mosmarrëveshje për të drejtat civile. I takonte ankuesit të vendoste nëse do t'i dorëzonte autoriteteve administrative një ankim të ri në lidhje me prezantimin e afateve të reja kohore.

26. Ankuesi shpjegoi se ishte ankuar për kohëzgjatjen e procedimeve përpara autoriteteve administrative për moszbatim të vendimit gjyqësor të datës 19 shtator 1996, i cili njihte ekzistencën e faktit juridik. Duke u mbështetur në gjykimin në çështjen *Ramadhi dhe të tjerët kundër Shqipërisë* nr. 38222/02, 13 nëntor 2007, ai u shpreh në favor të zbatueshmërisë së nenit 6 § 1 të Konventës.

27. Në lidhje me nenin 6 § 1 të Konventës, në aspektin e tij “civil”, në mënyrë që ky i fundit të bëhet i zbatueshëm, duhet të ekzistojë një diskutim (*kontestim*) për një “të drejtë” e cila mund të thuhet, të paktën mbi shkaqe të argumentueshme, se njihet nga ligji vendas. Diskutimi duhet të jetë i vërtetë dhe serioz. Mund të ketë lidhje jo vetëm me ekzistencën aktuale të një të drejte, por edhe me shtrirjen e saj dhe mënyrën e ushtrimit të saj. Për më tepër, rezultati i procedimeve duhet të jetë vendimtar në mënyrë të drejtpërdrejtë për të drejtën civile në fjalë (shiko midis shumë autoriteteve të tjera, *Gorou kundër Greqisë* (nr. 2) [DHM] nr. 12686/03, § 27, 20 mars 2009).

28. Në çështjen në fjalë, ankuesi në të vërtetë u ankuar për kohëzgjatjen e procedimeve përpara autoriteteve administrative. Në përputhje me ligjin vendas, ai dorëzoi një ankim për njohjen, kthimin dhe/ose kompensimin e pronës së tij. Pavarësisht mungesës së një vendimi në lidhje me ankimin e tij, procedimet përpara autoriteteve administrative ishin vendimtare për përcaktimin e së drejtës së trashëguar të ankuesit mbi pronën, e cila është civile nga vetë natyra e saj (shiko gjithashtu, *Ramadhi dhe të tjerët kundër Shqipërisë* nr. 38222/02, §§ 35-37, 13 nëntor 2007, në të cilin Gjykata vendosi që neni 6 § 1 të zbatohet për procedimet përpara Komisionit, i cili i kishte njohur të drejtat mbi pronën së ankuesit dhe kishte akorduar kompensim në vend të kthimit të tokës).

29. Në këto rrethana, Gjykata vendos që në çështjen në fjalë të zbatohet neni 6 § 1 i Konventës, dhe për pasojë, rrëzon kundërshtimin e Qeverisë.

2. Shfrytëzimi i mjeteve vendase

a) Parashtrimet e palëve

30. Qeveria ngriti një sërë kundërshtimesh në lidhje me pamundësinë e ankuesit për të shfrytëzuar mjetet vendase. Sipas tyre, ankuesi nuk mundi të paraqiste: i) një ankesë administrative sipas nenit 137 të KPA-së dhe, në vijimësi, një akt civil bazuar në nenin 324 të KPP-së; ii) një akt për dëmet kundër shtetit sipas ligjit për detyrime ekstra kontraktuale të shtetit; iii) një kërkesë të freskët në Komision në përputhje me seksionet 17 dhe 19 të ligjit për pronën 2004; iv) një kërkesë bazuar në seksionin 22 të ligjit për pronën të vitit 2004; dhe v) një kërkesë për apelim jashtë afatit. Më tej, Qeveria parashtrroi se ankesa e ankuesit ishte kundërshtuar nën zë, në zbatim të nenit 77 të KPA-së.



31. Ankuesi komentoi se nuk kishte asnjë mjet efikas për t'u shfrytëzuar.

b) Vlerësimi i Gjykatës

i) Për sa i përket një ankese administrative sipas nenit 137 të KPA-së dhe një akt civil sipas nenit 324 të KPP-së

32. Tashmë Gjykata e ka rrëzuar kundërshtimin e Qeverisë në lidhje me mosdorëzimin e një ankimi sipas nenit 137 të KPA-së dhe nenit 324 të KPP-së në çështjen *Luli dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, cituar më sipër, §§ 79–80. Nuk ka asnjë bazë që të urdhërohet një nisje nga këto gjetje. Për këtë arsye, Gjykata e kundërshton këtë kundërshti.

ii) Në lidhje me një veprim për dëmet sipas ligjit të përgjegjësisë ekstrakontraktuale të shtetit

33. Gjykata vëren se Qeveria nuk ofroi ndonjë ligj vendas nga vendimet e gjykimeve, të lidhur me çështjen, duke mbështetur argumentin se një ankim bazuar në një ligj përgjegjësie ekstrakontraktuale të shtetit kishte çdo mundësi për sukses në një situatë të ngjashme, ku autoritetet njihnin përgjegjësinë e tyre ekstrakontraktuale dhe akordojnë kompensimin sipas ligjit (shiko për shembull *Scoppola kundër Italisë (nr. 2)* [DHM], nr. 10249/03, § 71, 17 shtator 2009). Për këtë arsye, Gjykata e rrëzon këtë kundërshtim.

iii) Në lidhje me kërkesën e re sipas seksioneve 17 dhe 19 të ligjit mbi pronën, i vitit 2004

34. Sipas Gjykatës, kërkesa adresuar një ankuesi të paraqesë një ankim të ri, sipas seksioneve 17 dhe 19 të ligjit për pronën të vitit 2004, nuk është e barasvlershme me marrjen e një vendimi për ankimin e tij të pashmangshëm përpara Komisionit, i cili nuk kishte marrë një vendim që prej vitit 1996. Për këtë arsye, Gjykata e rrëzon këtë kundërshti.

iv) Në lidhje me kërkesën bazuar në seksionin 22 të ligjit të pronës së vitit 2004.

35. Bazuar në ligjin për pronën të vitit 2004, ishte i nevojshëm një ankim i ri, me kushtin që të drejtat mbi pronën të një pronari të mëparshëm të jenë njohur më herët me një vendim komisioni. Në çështjen në fjalë, nuk ishte marrë asnjë vendim i tillë në favor të ankuesit. Prandaj, Gjykata hedh poshtë kundërshtimin e Qeverisë.

v) Në lidhje me një kërkesë për apelim jashtë afatit kohor

36. Gjykata vëren se Qeveria nuk përcaktoi afatin kohor, një detaj të cilin ankuesi nuk e kishte vënë re dhe për të cilin ai duhej të kishte dorëzuar një kërkesë për të apeluar jashtë afatit kohor.

vi) Në lidhje me zbatimin e nenit 77 të KPA-së

37. Gjykata vëren se ligji për pronën, i hartuar *lex specialis*, nuk parashikonte kundërshtimin e heshtur pasi të përfundonin afatet kohorë. Përgjigjet e autoriteteve në vitin 2002 konfirmuan faktin se ankesa ishte ende në pritje të një vendimi (shiko paragrafin 9 më sipër). Kështu, Gjykata rrëzon kundërshtimin e Qeverisë.

3. Përfundim

38. Gjykata arrin në përfundimin se është e dukshme se ky ankim nuk është i pa bazuar në fakte, sipas interpretimit të nenit 35 § 3 (a) të Konventës. Duke qenë se nuk është i papranueshëm në ndonjë argument tjetër, atëherë ankimi duhet të deklarohet i pranueshëm.

D. Cilësitë

39. Më tej Qeveria pohoi se Komisioni kishte udhëhequr procedimet në përputhje me ligjin. Më 19 nëntor 2002, ai kishte informuar ankuesin se ankimi i tij do të shqyrtohej sapo të hynte në fuqi ligji i ri për pronën. Agjencia kishte informuar ankuesin për vendimin e saj, më 14 korrik 2008. Sipas tyre, ankuesi nuk kishte treguar kujdesin e duhur.

40. Ankuesi u ankua se procedimet administrative kishin marrë jashtëzakonisht shumë kohë. Ai pohoi se kishte qenë shumë i kujdesshëm për t'i dërguar disa kërkesa autoriteteve. Ai pretendonte se nuk ishte informuar kurrë për vendimin e Komisionit të datës 14 korrik 2008.

41. Gjykata do të vlerësojë arsyetueshmërinë e kohëzgjatjes së procedimeve nën disa rrethana të caktuara të çështjes dhe duke pasur parasysh kriteret e parashikuara në ligjin e saj sipas çështjeve, veçanërisht kompleksitetin e çështjes dhe sjelljen e ankuesit dhe të autoriteteve përkatëse. Në pikën e fundit, duhej të merrej parasysh edhe ajo çka ishte në rrezik për ankuesin (*shiko* midis të tjerëve, *Vilho Eskelinen dhe të tjerët kundër Finlandës* [DHM], nr. 63235/00, § 67, GJEDNJ 2007-II).

42. Gjykata shpjegon se procedimet filluan më 26 shtator 1996 dhe përfunduan më 14 korrik 2008. Kështu, ato kanë zgjatur 11 vjet, 9 muaj dhe 18 ditë përpara një niveli juridiksioni.

43. Nuk ka asnjë tregues se përcaktimi i të drejtave për pronën të ankuesit ishte kompleks. Qeveria nuk dha asnjë shpjegim çfarëdo për mos shqyrtimin nga ana e Komisionit të kërkesës së ankuesit gjatë kësaj kohe. Ankuesit nuk do t'i atribuohet asnjë vonesë. Disa herë me radhë ai



kishte bërë kërkesë për ecurinë e procedimeve përpara Komisionit.

44. Nga pikëpamja e asaj që ishte në rrezik për ankuesin, çka ishte njohja e të drejtave të tij për pronën e trashëguar, Gjykata kujton se i takon Shteteve Kontraktuese të organizojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë të tillë që autoritetet kompetente të mund të përmbushin kërkesat e nenit 6 të Konventës, duke përfshirë detyrimin për të marrë një vendim brenda një afati kohor të arsyeshëm (*shiko mutatis mutandis, Mishgjoni kundër Shqipërisë*, nr. 18381/05, § 59, 7 dhjetor 2010; dhe *Gjonbocari dhe të tjerët*, cituar në sipër, § 67).

45. Gjykata arrin në përfundimin se ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me kohëzgjatjen e procedimeve.

III. PRETENDIME PËR SHKELJEN E NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 1 TË KONVENTËS

46. Ankuesi shprehu pakënaqësinë se ka pasur një shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës, i cili parashikon si më poshtë:

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.”

47. Qeveria parashtrroi se kjo ankesë duhej të deklarohej e papajtueshme *ratione materiae*, duke qenë se të drejtat për pronën të ankuesit nuk ishin njohur nga Komisioni. Ankuesi nuk kishte ndonjë pritshmëri legjitime bazuar në ligjin vendas, por thjeshtë shpresën për njohjen e të drejtave të tij ndaj pronës. Dorëzimi i dokumenteve nuk akordonte automatikisht të drejtën ndaj pronës. I mbetej autoriteteve të vendosnin për dorëzimin e dokumenteve dhe duke pasur parasysh edhe interesin e publikut do të vendosnin nëse të drejtat e pronës të ankuesit do të njiheshin.

48. Ankuesi shpjegoi se kishte një “pritshmëri legjitime” se autoritetet do t’i njihnin të drejtën mbi pronën. Ai kishte dorëzuar të gjitha dokumentet e nevojshme në përputhje me ligjin. Mosnjoftimi i

ankuesit nga ana e autoriteteve për procedimet e pashmangshme bëri që ankuesi të besonte se i kishte përmbushur kërkesat statutorë dhe se nuk kishte arsye që kjo kërkesë të refuzohej.

49. Gjykata thekson se një ankues mund të pretendojë për shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1, vetëm nëse vendimet e kundërshtuara kanë të bëjnë me “pasurinë” e tij ose të saj, sipas interpretimit të atij parashikimi. Koncepti i “pasurisë” ka një kuptim autonom, i cili është i pavarur nga klasifikimi formal në ligjin vendas (*Former King i Greqisë (Ish-mbreti i Greqisë) dhe të tjerët kundër Greqisë* [GC], nr. 25701/94, § 60 GJEDNJ 2000-XII). “Pasuritë” mund të jenë “pasuri ekzistuese” ose asete, duke përfshirë kërkesat për të cilat një ankues mund të argumentojë se ka të paktën “një pritshmëri legjitime” (e cila duhet të jetë më konkrete sesa thjeshtë një shpresë), e cila do të realizohet, çka do të thotë se ai ose ajo do të gëzojë të drejtën mbi pronën (*shiko Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke* (vendim) [DHM], nr. 39794/98, GJEDNJ 2002-VII, § 69, dhe *Kopecký kundër Sllovakisë* [DHM], nr. 44912/98, § 35, GJEDNJ 2004-IX). Një kërkesë mund të konsiderohet si e vlefshme kur argumentohet mjaftueshëm se është e zbatueshme (*shiko Kopecký*, cituar më sipër, § 49; dhe *Stran Greek Refineries (Rafineritë Greke Stran) dhe Stratis Andreadis kundër Greqisë*, vendim i datës 9 dhjetor 1994, seritë A nr. 301-B, f. 84, § 59). Nga ana tjetër, shpresa për njohjen e ekzistencës të një të drejte të vjetër mbi pronën, e cila për një kohë të gjatë ka qenë e pamundur të ushtrohej në mënyrë efikase, nuk mund të konsiderohet si “pasuri”, bazuar në interpretimin e nenit 1 të Protokollit nr. 1. Po kështu edhe një kërkesë e kushtëzuar, e cila tejzgjatet për shkak të mospërmbushjes së kushtit, mund të mos njihet (*shiko Prince Hans-Adam II i Lihenshtajnit kundër Gjermanisë* [DHM], nr. 42527/98, § 83, GJEDNJ 2001-VIII). Sipas Gjykatës, një kërkesë është e kushtëzuar kur varet nga një ngjarje e pasigurt e së ardhmes. Asnjë “e drejtë legjitime” nuk hyn në lojë në mungesë të një kërkesë të mirëpërcaktuar për t’iu referuar një aseti.

50. Në çështjen konkrete, ankuesi ka qenë pala paditëse, i cili ka paraqitur një ankesë për njohjen, kthimin dhe/ose kompensimin e të drejtave të pronës. Duke bërë ankesën, ankuesi i besoi vendimit të gjykatës për njohjen e ekzistencës së faktit ligjor se i ndjeri, babai i tij, pretendohet se



zotëronte një sipërfaqe toke bujqësore (shiko paragrafin më sipër). Për pasojë, ankesa nuk kishte të bënte me “pronësinë ekzistuese” të vet ankuesit. Prandaj mbetet për t’u vendosur nëse ankuesi mund të konsiderohet se ka pasur një “prëshmëri legjitime”, se kërkesa, bazuar në njohjen e një vendimi gjykate që njeh një fakt ligjor, i referohet një aseti, i cili do të jepet në favorin e tij.

51. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se një vendim gjykate që njeh një fakt ligjor, të dhënat e dokumentuara të të cilit janë zhdukur, i marrë bazuar në nenin 388 të KPP-së, është i një natyre deklarative (gjithashtu, shiko *Marku kundër Shqipërisë*, nr. 54710/12, §§ 19 dhe 37, 15 korrik 2014). Një vendim i tillë në vetvete nuk i referohet të drejtave të pronës së një kërkuesi apo ndonjë të drejte tjetër çfarëdo qoftë ajo. Sipas ligjit vendas, njohja e të drejtave mbi pronën të një kërkuesi i përkiste Komisionit, i cili ishte autoriteti administrativ kompetent, që merrej me kërkesat për kthimin dhe kompensimin e pronës ish pronarëve (shiko *Ramadhi dhe të tjerët*, cituar më sipër, § 25). Komisioni nuk e përmbush në mënyrë automatike pretendimin e kërkuesit për kthimin dhe/ose kompensimin e pronës, duke pasur parasysh të drejtat e tij ndaj pronës, që njihen nga një gjykatë sipas nenit 388 të KPP-së. Komisioni duhet të sigurohet se ankesa përmbush kërkesat statutores, siç parashikohet në ligjin për pronën. Ligji bazuar në vendimet e Gjykatës së Lartë në vijim ofron mbështetje në aspektin se një vendim i tillë gjykate nuk mjaftonte të njihete automatikisht të drejtat e një kërkuesi mbi pronën (shiko paragrafin 22 më sipër).

52. Rezulton se ankuesi nuk ka as të drejtë dhe as një kërkesë që mbështet “prëshmërinë legjitime”, sipas ligjit të nxjerrë nga vendimi i Gjykatës për të fituar rikthimin e pronës në fjalë dhe në vijim asnjë “pasuri” sipas interpretimit të nenit 1 të Protokollit nr. 1. Më tej vijohet, se kjo ankesë është e papajtueshme me Konventën *ratione materiae* dhe duhet të kundërshtohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

III. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

53. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme,

Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”

A. Dëmi

54. Ankuesi kërkoi 30,000 euro (EUR) për dëmin jomonetar.

55. Qeveria kontestoi kërkesën me justifikimin se nuk ishte e detajuar dhe nuk bazohej në asnjë dokument.

56. Gjykata gjykon se ankuesit duhet t’i jetë shkaktuar dëm jomonetar. Duke gjykuar me paanshmëri, ajo i akordon atij EUR 7,000.

B. Kostot dhe shpenzimet

57. Ankuesi kërkoi EUR 2,600 për kostot dhe shpenzimet e bëra në Gjykatë, nga të cilat EUR 130 ishin për dorëzimin e ankimit, EUR 1,900 për dorëzimin e vëzhgimeve, EUR 290 për këshillim ligjor dhe EUR 280 për shpenzimet administrative dhe për përkthimet.

58. Qeveria e kontestoi kërkesën me argumentin se ankuesi nuk i mbështeti dhe nuk i specifikoi shpenzimet, sipas edhe Rregullit 60 § 2 të Gjykatës.

59. Gjykata argumenton se kostot dhe shpenzimet, bazuar në nenin 41, nuk do të akordohen, nëse nuk gjykohet se ato janë bërë faktikisht, kanë qenë të nevojshme për t’u bërë, dhe janë bërë në mënyrë racionale (shiko *Driza*, cituar më sipër, § 141). Për më tepër, kostot ligjore janë të shlyeshme vetëm nëse kanë lidhje me shkeljen e konstatuar (shiko *Vistiņš dhe Perepjolkins kundër Letonisë* (shpërblim i drejtë) [DHM], nr. 71243/01, § 50, GJEDNJ 2014).

60. Gjykata vëren se nuk i janë dhënë faturat mbështetëse për të provuar se të gjitha shpenzimet e bëra janë reale. Në vijim, ajo bën pyetjen nëse shpenzimet e mbetura janë bërë në mënyrë të arsyeshme. Duke pasur parasysh dokumentet në zotërimin e saj si edhe konstatimet, Gjykata i akordon ankuesit EUR 850 për procedimet e Strasburgut.

C. Kamatëvonesa

61. Gjykata e shikon të arsyeshme që kamatëvonesa duhet të bazohet në normën huadhënëse marxhinale të Bankës Qendrore Evropiane, duke i shtuar pikë trepërqindëshe.



PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË
MËNYRË UNANIME,

1. *E deklaron* ankesën në lidhje me kohëzgjatjen e tepruar të procedimeve të pranueshme dhe pjesën tjetër të ankimit të papranueshëm;

2. *Vendos* se ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me kohëzgjatjen e procedimeve;

3. *Vendos*

a) se shteti i paditur duhet t'i paguajë ankuesit, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi u bë i formës së prerë në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, shumat e mëposhtme, që duhet të konvertohen në vlerën monetare të shtetit të paditur, në normën e zbatueshme në datën e zgjidhjes:

i) EUR 7,000 (shtatë mijë euro), plus çdo taksë e cila mund të jetë e tarifueshme, në lidhje me dëmin jomonetar;

ii) EUR 850 (tetëqind e pesëdhjetë euro), plus çdo taksë që mund të jetë e tarifueshme për ankuesin, në lidhje me kostot dhe shpenzimet;

b) se që nga data e përfundimit të afatit tremujor të sipërpërmendur dhe deri në zgjidhjen përfundimtare, interesi i thjeshtë duhet të jetë i pagueshëm në shumat e mësipërme në një normë të barabartë me normën marxhinale të huadhënies të Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së kamatëvonesës plus pikë trepërqindëshe;

4. *Pezullon* pjesën e mbetur të kërkesës së ankuesit për shpërbllim të drejtë.

E hartuar në anglisht dhe e mbajtur me shkrim, më 3 dhjetor 2015, sipas nenit 77 §§ 2 dhe 3, të Rregullores së Gjykatës.

André Wampach
Zëvendëssekretare

Mirjana Lazarova Trajkovska
Presidente

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 04 2427005, 04 2427006

Çmimi 168 lekë